



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit të vitit 2023, mbajtur më 08.08.2022, i cili filloi në orën 14:00.

Në mbledhje morën pjesë: **Emine Haxholli, Tefik Sadrija, Fidan Vllasaliu, Shkelzen Domi, Gëzim Zeqiri, Mentor Zeka, Albion Zeka, Gëzim Sveçla, Amir Simnica, Fatos Dili, Donjeta Dragusha, Durim Berisha, Besart Peshku, Arbnora Berisha** dhe **Rashit Gashi**.

Të pranishëm ishin edhe : **Alban Zogaj**, nënkryetar, **Valbona Makolli**, drejtore e Drejtorisë së Financave, **Arta Balaj**, drejtore e Drejtorisë së Kulturës, **Granit Rugova**, drejtor në Drejtorinë e Sportit, **Premtim Fazliu**, zyrtar nga Drejtoria e Mirëqenjes Sociale, **Hysri Bunjaku**, zyrtar nga Drejtoria e Sportit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Arton Brahim**.

Valbona Makolli, drejtore, përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë, dhe i falenderojë për bashkëpunimin e vazhdueshëm. Ajo i njoftoi rreth materialit dhe propozimeve që janë bërë për planifikimin e buxhetit, mirpo këto janë vetëm propozime dhe nuk duhet që nuk mund edhe të ndryshojnë. Prandaj kërkesat e juaja janë të mirëpritura nga ne, dhe pas përfundimit të dëgjimeve buxhetore të gjitha kërkesat e juaja do të shqyrtojmë dhe ti shohim mundësit për realizimin e tyre. Komuna e Prishtinës për vitin 2023, duke e përfshirë edhe Ligjin për kryeqytetin, përafërsisht i kemi diku rreth 105,495,981 euro, të ndara në pesë kategori kryesore: Paga dhe mëditje 33 milion, mallra dhe shërbime 27 milion e 500 mijë euro, komunal 2 milion e 700 mijë euro, subvencione 4 milion, e 650 mijë euro, dhe në investime kapitale diku 40 milion, e 156,981 mijë euro. Materialin të cilin e kam paraqitë janë vetëm investimet kapitale të cilat janë marrë në bazë të kërkesave të propozuara nga vizitat e kryetarit nëpër lagje të ndryshme të kryeqytetit, duke pasur për bazë punimet në Hartat zonale dhe Planit Zhvillimore Komunal. **Shkelzen Domi**, qytetar dhe kryetar i klubi të tenisit “Dielli” në Prishtinë, tha se pas 8 vitesh, fushat e tenisit në Taukbaçë, këtë vitë në janë dhënë në shfrytëzim për tri vite nga “Sport Marketingu”.

Faqe 1 nga 5

Po ashtu janë edhe dy fusha të tenisit në Gërmi të cilat janë në menaxhim të “Sport Marketingut”, dhe nuk i plotësojnë kushtet.

Kërkesat tona janë për shtruarjen e gjashtë fushave të tenisit, duke i llogaritur edhe ato dy fusha në Gërmi, përafërsisht 1.5 km, dhe kështu së bashku me Federatën e Tenisit të Kosovës, pasi ti kishim plotësuar kushtet, do të kishim mundur ta organizojmë ndonjë turnir ndërkombëtar. I gjithë ky buxhet mund të kushtojë diku përafërsisht 25 mijë euro. Ndërsa tani për tani vetëm për këto fusha momentale, për tu shtruar shtresa e mirë dhe e re, ka një qmim diku 15 mijë euro. Pra me këto pak investime ne mund të organizojmë turne të ndryshëm tenisi, duke përfshirë edhe turnet ndërkombëtar për grupmoshat e reja. Ndërsa zgjidhja më e mira do të ishte nëse do të na ishte siguruar një “Balon”, me dy fusha tenisit për të pasur mundësinë e zhvillimit të lojërave të tenisit edhe gjatë stinës së dimrit, investim ky i cili mund ta ketë poashtu një kosto diku rreth 100 mijë euro.

Fatos Dili, qytetar, tha se i ka shikuar të gjitha këto propozimet buxhetore në pjesën sportive që do të bëhen, dhe ajo se qfarë më inteseson të dijë është, renovimi i Palestrës së madhe sportive, koha kur do të bëhet? Edhe destinimi i shfrytëzimit të kësaj salle më duket se ka ndryshuar, tash do të jetë aty me inovacione, pra nuk do të ketë sport por do të ketë shfrytëzim të kësaj salle jo për atë të cilën është e paraparë. Dhe pyetja tjetër te këto tribunat e ekipeve “Ramiz Sadiku”, “Flamurtari”, dhe “Kosova e Prishtinës”, shumë mirë që bëhen këto, mirpo na e kemi këtu në kryeqytet një klub më të madhë siq është klubi i futbollit “Prishtina”. Ne të gjithë e dimë se ky klub për shumë vite ka pasur probleme të mëdha rreth organizimit, pastaj kur edhe Ministria e mori stadionin për të rinovuar, dhe kanë pas shumë shpenzime për ta mbajtur klubin. Para dy viteve ky klub u shpallë kampion dhe ne të gjithë u mburrëm me ta, ndërsa vitin e kaluar kur ata kishin nevojë dhe kërkuan ndihmën e Komunës, ju kthejnë se ju jeni klub privat. Pra e gjithë ajo se qfarë dua të them është se edhe institucioni duhet të qartësojë se, a janë klub privat dhe mos të gëzohen për sukseset e tyre, apo janë klub i qytetit dhe duhet të ju ndihmojmë edhe atyre. Mendoj se para të gjitha këtyre tribunave të cilat janë propozuar, është ky klub ai i cili meriton një tribunë dhe rrethoja, në një tokë të cilët ata e kanë në Bërnice dhe të cilën nuk kanë mundur asnjëherë ta shfrytëzojnë. Ai po ashtu tha se dua të dijë se a ka pas ndonjë iniciativë nga Komuna e Prishtinës, që palestra “1 Tetori”, ti kthehet Komunës së Prishtinës, duke e ditur se kemi mbi 50 klube që të gjitha aktivitetet e tyre i kryejnë në Pallatin e Rinisë, e cila është e pamundur për të gjitha këto klube. Ne kemi klubin e basketbollit femrat, të cilët janë edhe kampionë dhe nuk kanë asnjë termin në Pallatin e Rinisë, për ushtrime. Disa nga klubet sportive tani në këtë qeverisje janë evidentua në Pallatinë e Rinisë, dhe kryejnë një pagesë, po kjo pagesë mendojë se duhet të jetë vetëm për ato ekipe të cilat e kanë ekipen A, dhe nuk kanë inkasim. Psh disa shkolla të futbollit, basketbollit kanë mbi 200-300 fëmijë të cilët marrin të hyra, dhe ata e kanë vetë financimin, pra Komuna duhet të ketë një përkrahje për ata të cilët nuk mund të gjenerojnë të hyra. Pyetja tjetër është ajo për stadionin e fshatit Barilevë, siq e dimë ka qenë edhe si projekt i kryetarit Përparim Rama. Ata tash edhe veq janë themeluar si klub, por mendoj se aty mungonë rrethoja e stadiumit, mungon tribuna. Por ajo më shqetësuese është se ajo tokë i takon Komunës, dhe aty banorët për rreth kanë filluar që ta privatizojnë atë zonë, dhe tash thuajse është e

Faqe2nga5

pamundur që edhe në qoftë se do dikush të kontribojë në rregullimin e zhveshtoreve, pasi ajo zonë veq ka filluar të uzurpohet nga banorët. Tjetra është që fëmijët e klubit të futbollit të Prishtinës, të kenë të drejta të barabarta në terenet që janë pronë e Komunës, dhe jo që ata të kryejnë pagesa për të luajtur në ato fusha, duke e ditur se toka është e Komunës, dhe kanë të drejtë të gjithë ta shfrytëzojnë.

Valbona Makolli, drejtore, tha se do ti marrim parasysh këto kërkesa, dhe do ti shqyrtojmë edhe me drejtoritë tjera dhe të shohim se qfarë nga këto mund të realizojmë.

Granit Rugova, drejtorë, tha për renovimin e sallës së madhe të Pallatit të Rinis, ajo nuk është vendosur ende sakt, por ajo do të jetë një qendër rinore dhe jo qendër sportive ashtu siq ka qenë. Tjetra për sallën "1 Tetori", do të bisedojmë me ta dhe do ti shohim mundësitë e shfrytëzimit, pasi që ajo sallë ka kapacitet të zhvillimit edhe më të madh.

Fatos Dili, qytetarë, tha se salla të tilla si kjo e 1 Tetorit, janë edhe në gjashtë Komuna tjera, dhe vetëm salla 1 Tetori, nuk është në mbikqyrjen e Komunës, por në pronësi të Ministrisë së Arsimit.

Granit Rugova, drejtorë, tha se këtu e kemi edhe "Pallatin e Rinisë", dhe për këtë arsye ju ka dhënë Fakultetit të Edukatës Fizike.

Donjeta Dragusha, anëtare e Kuvendit të Komunës, tha se dua të dijë nga drejtoresha, se sa realisht ka mundësi të ndryshohet ky projektbuxhet, dhe sa ka mundësi të futen projektpropozime të reja? Ajo tha se në 8 vitet e fundit në fshatrat veriore të kryeqytetit, nuk është bërë asnjë investim nëpër fushat sportive.

Psh në fshatin Prugoc, është një tokë e cila do të ishte e mundur të kthehej në fushë sportive, pasi që dita ditës ajo veq shkon duke u ngushtuar dhe marr nga banorët aty dhe është më se nevojshme. Për sa i përket fushës në Barilevë, po besoj se aty veq është marr një nismë për tu punuar në atë drejtim, po besoj nga Drejtoria e Sportit veq është marr një pëlqim për shfrytëzimin e asaj fushe. Por ka mjaft probleme me banoret aty afer per shkak te uzurpimeve të pronave. Po ashtu në ato pjesë nuk kemi asnjë shtëpi kulture, dhe besoj se një e tillë do të ju ndihmonte shumë.

Emine Haxholli, qytetare, tha se kërkesa jonë ka të bëjë me mirëmbajtjen e varrezave në fshatin Makoc. Qështja kryesore në ato varreza është se disa nga të vrrarët që kanë qenë aty, ju janë tërhjekë varrezat dhe kanë mbetur vetëm gropa të hapura. Pra kërkesat kryesore janë së pari të mbulohen ato gopa të hapura, mirëmbajtja e tyre, një fontan aty e cila është jashtë përdorimit, po ashtu të rregullohet edhe ndriqimi.

Valbona Makolli, drejtore, tha se do ti shohim mundësit, do të bisedojmë me drejtoreshën e Drejtorisë së Parqeve për mirëmbajtjen e tyre, ndërsa sa i përket gropave në varreza do të bisedojm edhe me drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Amir Simnica, anëtar i Kuvendit të Komunës, tha se dëshironë të dijë nga Drejtoria e Sportit, për klubin futbollistik "Besëlidhja", i cili është klubi i dytë i krijuar mbas klubit të "Prishtinës". Në mungesë të infrastrukturës, së stadiumit, ai klub është shuar. Rreth këtij propozimi është diskutuar shumë edhe nga qeveritë e kaluara, por që nuk është bërë asnjë hapë në këtë drejtim. Në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Pronës, kemi shikuar se janë disa parcela komunale nga pjesa e Zllatarit, por që këtë vitë na kanë treguar se nuk mund të hyjmë, por pse jo të propozohet për vitet e ardhshme, pasi që është një ndër klubet më të vjetra në Prishtinë. **Granit Rugova**,

drejtorë, tha se deri tash nuk është se e kemi përmend problemin me klubin “Besëlidhja”, por natyrisht ata mundën me u drejtu te ne në Drejtorinë e Sportit, dhe në Drejtorinë e Pronës dhe ti shohim se cilat parcela janë më të përshtatshme.

Gëzim Sveçla, anëtar i Kuvendit të Komunës, tha se në bazë të propozim buxhetit po e shohim që është paraparë rregullimi i tribunës së stadiumit “Fadil Vokrri”. Por po e shohim që ky investim thuhet do të bëhet me ndarje për 3 vite, unë mendoj se kjo nuk mund të bëhet kështu, kjo nëse bëhet duhet të bëhet për 6 muaj, sepse e kemi të vetmin stadium të licencuar për gara ndërkombëtare, dhe nuk mundet 3 vite me u punu aty. Prandaj është mirë kur të bëhet ndarja buxhetore e sakt, me bartë diku tjetër ku është diçka më urgjente. Na me participu aty por për fizibilitet të mos bëhet me këtë 1 milionë të Komunës, le ti jap Ministria ose Federata, ndërsa këto të përdoren pasi të fillojnë punët. Për tribinat e klubeve, për Flamurtarin jemi në rregull, sepse e dimë se kanë nevojë për tribunë, por “Kosova e Prishinës” ka më shumë nevojë për zhveshtore se sa për tribunë, pasi atje edhe ashtu nuk është se ka shumë shikues për ta shikuar lojën. Kërkesa ime është se nëse ka mundësi që klubit të futbollit Prishtina, ti bëhet zhveshtorja në fushën të cilën e përdorin ata. Ndërsa te Drejtoria e Kulturës për qendrat kulturore, po e shohim që është paraparë 900 mijë euro për 3 vite. Kur të bëhet buxhetimi i saktë ndoshta nuk duhet të jenë të parapara 4 lagje, por dy lagje aty ku ka më shumë nevojë dhe të përfundohen brenda vitit kalendarik. Po ashtu tha se mbështetë kërkesën për riaktivizmit të klubit “Besëlidhja”, i cili ishte një kohë edhe krenaria e qytetit.

Fatos Dili, qytetarë, tha se nuk e di a është informacion i sigurt, pasi në media ka dalë se njëra prej ndërmarrjeve, siq është “Sport Marketing”, do të merr në menaxhim të gjitha terrenet sportive në Komunën e Prishtinës? Nëse kjo është e sakt mendoj se do të ishte mirë për ato klube të cilat nuk kanë terene të veta sportive, dhe nga ajo ndërmarrje e cila i merr në menaxhim të ketë një barazi të shfrytëzimit për të gjithë, dhe jo një klub të posedojë një pronë komunale, ndërsa klubet tjera të kryejn pagesa për shfrytëzimin e fushës te ata, ashtu siq edhe e dimë që ka ndodhur deri tash. Ai mendon se në qoftë se formula do të ishte ndërmarrja, atëher do të ishte gjëja më e mirë e sportit në Komunën e Prishtinës, sepse do të ketë një pronar të këtyre klubeve sportive.

Alban Zogaj, nënkryetar, tha se nuk kemi diçka zyrtare akoma, ka pas disa analiza apo studime, dhe nuk flitet për të gjitha terrenet sportive, por më shumë për këto fushat e vogla të cilat janë investuar nga Komuna, por më vonë kanë mbet pa mirëmbajtje dhe pa menaxhim, prandaj kemi menduar se në qoftë se do të jenë nën menaxhimin e ndonjë ndërmarrje, do të ketë menaxhim më të mirë. Ndërsa fushat e mëdha siq janë stadiumet, ato jepen në shfrytëzim për kohët të caktuar klubeve, dhe për aq kohë ata janë vetë pronarë, ashtu siq ndodhë edhe në vendet tjera. Pra na jemi duke menduar se si të ju ofrojmë shërbime sa më të mira qytetarëve të Prishtinës dhe të kenë mirëmbajtje sa më të mirë.

Fatos Dili, qytetarë, tha se mendon që Komuna e Prishtinës duhet të ketë tender për shfrytëzimin dhe menaxhimin e një prone publike, mirpo këto klube e kanë gjetë atë vakumin institucional dhe kështu kanë vazhduar. Ai tha se nëse një klub i ka 500 fëmijë, të cilën pagujnë nga 50 euro, të cilët janë fëmijë të këtij qyteti, dua të di cila është kosto që e kthen mbrapa Komuna e Prishtinës nga ajo që ai fiton? Deri më tani ato klube të cilët kanë marr tokën e

Komunës, nuk kanë investuar asnjëher në ato fusha, aty gjithmonë ka investuar Ministria apo Federata e Futbollit të Kosovës. Nuk jam kundër që ata të fitojnë, mirpo fito me fëmijë, fito me tokë dhe nga subvencionet e Komunës së Prishtinës, ose të largohen nga këto subvencionet ose të ju mundësojnë edhe klubeve tjera shfrytëzimin e asaj fushe. Si ka mundësi që klubi i Besëlidhjes të shuhet sepse nuk ka tokë, dhe një klub që është themeluar në vitin 2019, të ketë tokë të vetën, stadium të vetin dhe po ju mundësohet tribuna dhe zhveshtore. Unë besoj se nuk është e njëjtë sikur klubi i futbollit "Prishtina", të ketë vetëm 50 fëmijë, ndërsa klubet tjera të ligës së 2 apo 3, të kenë nga 200 apo 300 fëmijë, sepse është ndryshe sikur një fëmijë, apo talent të del në Evropë nga klubi i Prishtinës, sikur nga një që del nga një klub i ligës së 2 apo 3. Ai poashtu tha se klubi futbollistik "Prishtina", ka probleme pasi ju ka mundësuar të zhvilloj ndeshje kampionale në stadiumin e Prishtinës, ndërsa Federata e futbollit i ka thënë se aty nuk mund të luash, në një pronë të cilës i takon Komunës së Prishtinës dhe ju keni ndërhyrë si drejtor dhe ekzekutiv për të zhvilluar ajo. Nuk e di se me çfarë dokumentacioni Federata e futbollit i ka ndaluar qasjen klubit të futbollit, të cilët e kanë edhe një kontratë që deri në vitin 2024, ata janë shfrytëzues të stadiumit, dhe ata nuk kanë pasur qasje edhe pse me dokumenta nga dikush që nuk ka fare dokumente. Ai tha se qasja për sportin duhet të ndryshojë, pasi që ne dita ditës jemi duke marrë pjesë edhe në garat ndërkombëtare, si psh në Champions, dhe ti dallojm ato klube të cilat janë dhe punojn si biznese, me ato klube të cilat e kanë prioritet masivizimin dhe jo përfitimin personal.

Alban Zogaj, nënkryetar, tha se është më mirë të fokusohemi në propozimet buxhetore, se kah ti orientojmë financat për vitin 2023. Ne kemi disa propozime tona, po ashtu edhe disa nga propozimet e juaja të cilat mendojmë se do të ishin diqka e mirë dhe në fund i përfshijmë në buxhet, votohet në asamble dhe atëherë pas miratimit nxjerrim si dokument i cili na obligon se si të shfrytëzojmë buxhetin tonë për vitin 2023.

Mbledhja përfundoi në orën 15:20

Procesmbajtësi
Artan Brahim

Faqe5nga5

Pjesëmarrja në diskutime publik lidhur me Planifikimin e buxhetit të vitit 2023,

më 08.08.2022.

| Emri dhe Mbiemri | Gjinia M/F | E-mail | Nënskrimi |
|---------------------|---------------|--------|-----------|
| 1 Emine Haxholli | | | |
| 2 Tetie Smajevic | | | |
| 3 FIDA VEJALU | | | |
| 4 SHKELZEN DOMI | | | |
| 5 Gezi Zegiri | | | |
| 6 Heutet Zekaj | | | |
| 7 Adriani Zekaj | | | |
| 8 Sëzim Svecua | | | |
| 9 Amir Hysaj | | | |
| 10 FATOS BILI | | | |
| 11 Donjeta Dragusha | | | |
| 12 Duvrin Beqishta | | | |
| 13 Besart Resku | | | |
| 14 Almeta Berisha | | | |
| 15 ZASHI BRASHI | | | |
| 16 | | | |
| 17 | | | |